

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE KOMISIONIT EVROPIAN, PËR PROGRAMIN E VEPRIMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR IPA II, SHQIPËRI - KOSOVË 2014-2020, ALOKIMET PËR VITIN 2016”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji propozon ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016.

Marrëveshja e financimit është miratuar, në parim, nga Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.249, datë 29.3.2017, “Për miratimin, në parim, të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016”.

Kjo marrëveshje financiare u nënshkrua për palën shqiptare nga ish-ministri i Integrimit Evropian, më 26.7.2017.

Programi BNK Shqipëri-Kosovë 2014-2020 u miratua nga Komisioni me vendimin zbatues C(2014) 9574, të datës 11 dhjetor 2014. Alokimet e vitit 2016, për këtë program, financohen nga një grant i BE-së, nëpërmjet Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA) me një buxhet total, për të dyja vendet, prej 1 411 765 euro (bashkëfinancimi kombëtar i shteteve 180 000 euro, kontributi i BE-së 1 200 000 euro). Sqarojmë se, në total, kontributi që do të japë BE-ja për zbatimin e përbashkët të programit Shqipëri-Kosovë, për periudhën 2014-2020, arrin vlerën 8 400 000 euro, por alokimet e mëtejshme do të jenë subjekt i nënshkrimit të marrëveshjeve të tjera financiare ndërmjet vendit tonë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian.

Autoritetet shqiptare dhe kosovare kanë punuar së bashku, në mënyrë koherente, për përgatitjen e programit, duke përfshirë edhe palët e interesuara nga institucionet qendrore, institucionet vendore të zonave përfituese të programit, dhomat e tregtisë dhe të industrisë, bizneset dhe organizatat lokale.

Zona e programit ku do të zbatohen projektet mbulon një territor prej 8 335 km², me një popullsi që arrin në rreth 936 761 banorë, nga të cilët 76% jetojnë në territorin e Kosovës dhe 24% në anën shqiptare të zonës së programit. Në Shqipëri, zonat përfituese përfshijnë rajonet e Kukësit dhe të Lezhës (8 bashki, me një total prej 362 vendbanimesh), ndërsa në Kosovë, përfshijnë Rajonin Ekonomik Perëndimor dhe Rajonin Ekonomik Jugor (12 bashki).

Programi i bashkëpunimit Shqipëri-Kosovë mbështet shkëmbimin e eksperiencës, të njohurive dhe përmirësimin e politikave publike ndërmjet autoriteteve kombëtare, rajonale e lokale si dhe aktorëve të tjerë të rajoneve të lejueshme në zonën e programit. Programi ka për qëllim kryesor të kontribuojë në zhvillimin afatgjatë të zonave si dhe të forcojë më tej bashkëpunimin natyral ndërmjet dy shteteve.

Duke marrë parasysh aspektet problematike, që ndikojnë në ekonominë e zonës dhe zhvillimin e saj të qëndrueshëm, programi do të fokusohet në këto prioritetet tematike:

1. Mbrojtja e mjedisit, përshtatja dhe zbutja e ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i riskut;
2. Turizmi dhe trashëgimia natyrore e kulturore;
3. Rinia dhe arsimi, me fokus nxitjen e punësimit.

Marrëveshja e financimit për këtë program përbëhet nga 5 pjesë:

- i. Shtojca I: Programi i Veprimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Shqipëri-Kosovë për vitet 2015-2017 - vendimi zbatues i Komisionit C(2015)5238, date 22 korrik 2015;
 - ii. Shtojca IA: Programi IPA II BNK 2014-2020 ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës;
 - iii. Shtojca II: Kushtet e përgjithshme;
 - iv. Shtojca III: Modeli i raportit vjetor BNK për zbatimin e asistencës IPA II (Neni 80 i marrëveshjes kuadër;
 - v. Shtojca IIIA: Modeli i raportit vjetor mbi zbatimin e asistencës IPA II në përputhje me nenin 58 të marrëveshjes kuadër.
- *Programi i veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri-Kosovë për vitet 2015-2017 (Shtojca I) përmban një përshkrim të modaliteteve të zbatimit të programit, përfshirë alokimet për secilin vit financiar, prioritetet e programit, kushtet e thirrjeve për projektpropozime dhe monitorimin e performacës së programit.*

- *Programi i bashkëpunimit* (Shtojca IA) përmban një analizë të karakteristikave kryesore të territorit të lejueshëm, prioritetëve dhe ofron një pasqyrë të sfidave të zhvillimit që rrethojnë zonën e programit, të cilat mund të trajtohen nëpërmjet projekteve të përbashkëta.
- Një pjesë e rëndësishme e marrëveshjes janë edhe *kushtet e përgjithshme* (shtojca II), ku parashikohen përgjegjësitë dhe strukturat zbatuese të programit. Ky program do të zbatohet me menaxhim të drejtpërdrejtë nga Komisioni Evropian, nëpërmjet Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë.
- *Shtojcat III dhe IIIA të marrëveshjes* paraqesin modelet e raportit vjetor të zbatimit për secilin program të bashkëpunimit ndërkufitar, përfshirë dhe një raport të përbashkët për të gjitha programet e bashkëpunimit ndërkufitar që përfiton vendi ynë, pavarësisht zbatimit nën menaxhimin indirekt apo direkt nga ana e Komisionit Evropian.

Shqipëria dhe Kosova do të bashkëpunojnë ngushtë me Delegacionin e BE-së në Tiranë për koordinimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të programit. Struktura institucionale e programit është e përbërë nga autoriteti kontraktues i programit (DBE në Tiranë), Komiteti i Përbashkët i Monitorimit, Sekretariati i Përbashkët Teknik si dhe koordinatorët kombëtarë të fondeve IPA të dyja vendeve përfituese.

Sjellim në vëmendje se për dy marrëveshje të tjera financimi është rënë dakord ndërmjet këtyre palëve për të njëjtin program, por për alokimet e viteve 2014 dhe 2015.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektligji është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje financiare do të mundësojë zbatimin e përbashkët të projekteve në të ardhmen, ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, duke u mundësuar, në këtë mënyrë, përfituesve nga të dyja vendet të shkëmbejnë jo vetëm njohuritë dhe përvojat, por edhe të prodhojnë rezultate të dukshme në sektorin e mjedisit, turizmit, punësimit etj.

Programi i bashkëpunimit Shqipëri-Kosovë ka reflektuar rëndësinë që BE-ja i kushton çështjeve horizontale dhe ndërsektoriale. Çështje të tilla janë reflektuar në të gjitha prioritetet e zgjedhura për programin, si krijimi i partneriteteve ndërkufitare, “autorësia” vendore dhe mundësitë e barabarta, garantimi i mosdiskriminimit të minoriteteve dhe të kategorive të cënueshme, pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile, mbrojtja e mjedisit, të drejtat gjinore, si edhe qeverisja e mirë.

Në lidhje me evidentimin e problematikave, problematika kryesore pas miratimit të projektligjit, do të lidhet, kryesisht, me mundësitë dhe kapacitetet e përfituesve shqiptarë për përthithjen, hartimin e projektpropozimeve dhe zbatimin me sukses të projekteve të financuara nga ky program. Ndaj, në vijimësi, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme do të fokusohet në mbështetjen e përfituesve shqiptarë për zbatimin e suksesshëm të projekteve të financuara nga programi.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në përputhje me nenet 81, pika 1, e 100, të Kushtetutës, me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjin nr.37/2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)”.

Pas miratimit të projektvendimit nga ana e Këshillit të Ministrave, marrëveshja do t’i nënshtrohet ratifikimit me ligj nga ana e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, bazuar edhe në nenin 121, pika 1, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk përafron në vetvete ndonjë akt të legjislacionit të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon miratimin e propozimit për ratifikimin nga ana e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të marrëveshjes së financimit, ndërmjet

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016, me një vlerë prej 1 411 765 EUR për të dyja vendet. Ky buxhet do të përdoret për financimin e projekteve sipas akteve prioritare të paraqitura në pikën 1, të këtij relacioni.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, në cilësinë e saj si koordinatorë kombëtare e asistencës së BE-së për Shqipërinë, ngarkohet për zbatimin e projektligji.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Në lidhje me zbatimin e ligjit nr.146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, pavarësisht se ligji në fjalë i referohet projektakteve dhe projektdokumenteve strategjike me interes të lartë publik, është marrë iniciativa për publikimin e dokumenteve, për të cilat është gjykuar se mund të ketë interes nga ana e aplikantëve për këtë program. Procesi i përgatitjes dhe konsultimit të programimit filloi në mes të shtatorit të vitit 2013, duke vazhduar deri në maj 2014. Ky program u hartua nëpërmjet një procesi konsultimi të gjerë, që përfshin aktorët vendorë dhe përfituesit potencialë nga të dyja anët e kufijve. Një fazë e rëndësishme e konsultimeve ishte hartimi i pyetësorëve për institucionet e nivelit qendror, vendor dhe OSHC-të, për të mbështetur analizat PESTLE dhe SWOT për programin dhe për të siguruar një nga treguesit për identifikimin e prioritetëve të përbashkëta për zonën ndërkufitare.

Përveç kësaj, për të koordinuar procesin në nivel kombëtar, më 16 prill 2014 u organizua një takim konsultativ në Shqipëri me përfaqësues nga ministrinë e linjës që mbulojnë prioritetet tematike të propozuara në program.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Në këtë fazë është e pamundur që të jepet një vlerësim i të ardhurave dhe shpenzimeve për shkak se një ndarje e buxhetit prej 1 380 000 eurosh për secilin shtet përfitues për alokimin e vitit 2016 (bashkëfinancimi kombëtar i shteteve 180 000 euro, kontributi i BE-së 1 200 000 euro) mund të bëhet pas kontraktimit të projekteve fituese nga thirrja e dytë për projektpropozime. Gjithashtu, theksojmë se përfitues të këtij programi nuk do të jenë vetëm

institucionet shtetërore buxhetore por edhe organizata e shoqata të tjera jofitimprurëse (të cilat nuk ndikojnë në të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore).

KËSHILLI I MINISTRAVE